



#2 Zhabar, Mitrovicë

Komuna e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka 64,742 banorë, përfshirë qytetin dhe 44 fshatra dhe gjithsej 16,584 ekonomi familjare. Komuna e Mitrovicës mbase është një nga komunat që ka fituar dhe humbur më së shumti popullatë si pasojë e industrializimit të hovshëm dhe deindustrializimit pastaj. Asnjë fshat nuk është rritur, dhe 4-5 fshatra tërësisht janë braktisur, së paku siç shihet në rezultatet e regjistrimit të popullatës 2024.




Komuna është rritur për 20 mijë banorë mes vitit 1961 dhe 1971 dhe në rritëm më të ulët, kjo rritje ka vazhduar deri më 1991. Komuna ka rënë për 40 mijë banorë në ndërkohë, dhe pjesërisht kjo shpjegohet ehe me ndarjen e qytetit. Më 1948, në qytet kanë banuar 42% të popullatës së tërë komunës, dhe kjo ishte ngritur në 60% mes viteve 1971-1991 dhe tani duket se rënia e popullatës më tepër ka ndikuar në qytet sesa në fshatra, dhe tani përqindja ka rënë në 52%. Ky trend dëshmohej edhe nga ky grafik ku vërehet që qyteti ka rënë për 27% përdersia fshatrat për 17% edhe pse mund të jetë ndikuar diku shifra nga fakti se është krijuar komuna në veri, por e cila paraqitet tani.



Në grafikonin më lartë vërehet se përderisa popullsia ka rënë si në fshat (nga 37 mijë në 31 mijë) ashtu edhe në qytet (nga 46 mijë në 34 mijë), nuk ka rënë numri i ekonomive familjare (akoma afër 17 mijë). Ky është indikacion që rënia ka të bëjë me (a) demografinë, (b) migrimin e të rinjve, (c) lëvizjen e të rinjve në banesa të tyre.

Seria e rasteve studimore për punësim të grave në zonat rurale

Papunësia dhe arsimi i dobët i grave në zonat rurale mbeten mes sfidave më serioze socio-ekonomike në Kosovë, e cila rrjedh jo vetëm nga mungesa e vendeve të punës, por edhe nga barrierat strukturore si mungesa e transportit publik, shërbimeve parashkollore dhe mundësive për zhvillim personal. Për të adresuar këtë realitet, projekti “Vendimarrja me dialog: Përmirësimi i jetës rurale përmes avokimit të grupeve të interesit”, i zbatuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans–Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor”, synon të promovojë një qasje të re në politikëbërje. Dëshmitë nga disa mini-studime që kemi relizuar synojnë të nxisin dialog dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të grave në procesin e vendimarrjes publike. Argumenti ynë kryesor është për një bashkëpunim të qëndrueshëm mes shoqërisë civile dhe institucioneve, me qëllim krijimin e zgjidhjeve konkrete për të lehtësuar qasjen e grave në tregun e punës përmes dy intervenimeve publike: (a) hapja e sa më shumë kopshteve për të akomoduar fëmijët nga zonat rurale dhe (b) subvencionimi i transportit publik që lidh fshatrat me qytete dhe mes vete. Të gjitha dëshmitë janë se këto dy ndërhyrje do të rrisnin barazinë mes fëmijëve, do të rrisnin punësimin e grave, do të ngadalësonin shpërnguljen dhe në përgjithësi do të kishin efekt për një zhvillim më të hovshëm ekonomik në vend. Në kuadër të këtij projekti u krijua një Grup Avokues i Grave Aktiviste, i cili me mbështetje nga D4D, ka realizuar disa hulumtime në nivel të Kosovës dhe në disa fshatra të përzgjedhura për të identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në papunësinë e grave, duke vendosur kështu bazën për propozime të strukturuar dhe të adresuara politikisht.



Madhësia e familjeve është rritur nga 4.8 mesatarisht në 5.8 dhe tani ka rënë në 3.9 për tërë komunën edhe pse ka dallime mes qytetit dhe fshatit. Në fshat mesatarja e familjes është 4.8 dhe në qytet është vetëm 3.3. Për të kuptuar dinamikën më mirë, mund të shikohet edhe numri i banorëve për çdo fshat, për të parë se cili lloj i fshatit ka humbur më tepër popullsi dhe cilat janë veçoritë e atyre pak fshatrave ku është rritur


popullsia.

Në të kaluarën, Zhabari ishte rritur tepër shumë dhe ka tërhequr banorë të rinj për shkak të afërsisë me qytetin. Rritja ka qenë e vazhdueshme dhe veçanërisht nga vitet e 70ta, kur Mitrovica ka pësuar rritje për shkak të industrializimit të hovshëm të shtyra nga miniera e Trepçës. Edhe pse Trepça nuk ka punuar pas luftës, fshati është rritur edhe më shpejtë, (për 3.5 herë), mbase për shkak të afërsisë me qytetin apo si rezultat i shkatërrimit të fshatrave gjatë luftës. Rënia ka filluar pas vitit 2011 dhe tani ka rënë. Interesante se nuk ka rënë aspak numri i familjeve, por vetëm numri i banorëve, dtth kanë lëvizur të rinjtë apo familjet që kanë jetuar së bashku në familje të zgjeruar.

Kopshtet për fëmijë. Në gjithë Komunën e Mitrovicës është vetëm një kopsht publik i cili funksionon në disa lokacione me kapacitet për 300 fëmijë. Të pesë lokacionet janë në qytet dhe në asnjë fshat nuk ka kopsht publik. Në Mitrovicë janë edhe 5 kopshte private me 450-500 fëmijë. Në përgjithësi në kopshtin publik dhe atë privat, kopshtin parashkollor publik janë rreth 800 fëmijë, që është 9% e totalit të fëmijëve në komunë (pasi që në komunë janë 8472 fëmijë të moshës 0-4 vjeç). Në secilin fshat ka infrastrukturë rrugore, duke përfshirë asfaltin, ndriçimin dhe trotualet. Në pothuajse të gjitha fshatrat e Mitrovicës ka ndriçim publik.

Në fshatrat e Pejës nuk ka kopshte fare, as publike dhe as private. Nga muaji shtator 2025 pritet të funksionalizohet kopshti i parë në fshatin Vitomiricë, i cili do të jetë institucion publik nën ombrellën e kopshtit “Pëllumbat e Pages”.

Sa i përket numrit të fëmijëve në çerdhen publike aktualisht janë 410 fëmijë ndërsa për institucionet private nuk ka të dhëna të sakta as nga Drejtoria Arsimit dhe as nga Inspektoriati i Arsimit, por në ASK figuron numri prej 540 që është përdorur në grafikun në të djathtë.



Vendi	2011	2024	Dallimi	Vendi	2011	2024	Dallimi
Komunë	83,935	64,742	-19,193	Rekë	224	233	9
Bajgorë	1,098	327	-771	Selac	164	25	-139
Bare	841	298	-543	Stantërg	1,042	594	-448
Broboniq	1,023	731	-292	Suhodoll	1,013	967	-46
Gushac	475	456	-19	Svinjarë	567	564	-3
Kaqandoll	119	33	-86	Shipol	4,834	4,195	-639
Kçiq i Madh	3,412	2,880	-532	Shupkovc	1,518	1,368	-150
Kçiq i Vogël	1,348	1,396	48	Tërstenë	163	33	-130
Koprivë	55	47	-8	TuneliParë	1,006	644	-362
Koshtovë	1,702	1,387	-315	Vaganicë	2,000	2,548	548
Kovaçicë	27	2	-25	Vërbnicë	313	243	-70
Kutlloc	473	339	-134	Vidishiq	249	72	-177
Lisicë	519	465	-54	Vidomiriq	195	144	-51
Lushtë	637	577	-60	Vinarc epërm	362	328	-34
Maxherë	55	14	-41	Vinarc posht.	659	882	223
Mazhiq	253	90	-163	Vllahi	271	102	-169
Melenicë	475	208	-267	Zabërxhë	70	49	-21
Mitrovicë	46,230	33,628	-12,602	Zasellë	791	609	-182
Pirq	511	468	-43	Zijaqë	17		-17
Rahovë	396	226	-170	Zhabar i E.	1,070	936	-134
Rashan	364	164	-200	Zhabar i P.	7,394	6,470	-924

Fshati Zhabar (i epërm)

Popullsia në fshatin Zhabar të Epërm është rreth 936 banorë, me 187 ekonomi familjare dhe sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore. Ndodhet në komunën e Mitrovicës, në jug të Ibrit me popullsi shumicë shqiptare. Fshati ka shkollë fillore, dyqane të vogla, objekte fetare dhe lidhje rrugore të mirë me Mitrovicën. Bujqësia dhe blegtoria janë dy sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe të ardhurave për banorët e këtij fshati që merren me kultivimin e drithërave (misër, grurë e tërshërë), perimeve dhe blegtorisë, duke përfshirë rritjen e bagëtive (lopëve dhe viçave për majmëri) dhe bletari, turizëm.



Zhabar	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
Banorë	265	291	389	582	784	972	1070	936
Numri i familjeve	41	42	54	78	101	128	187	187
Madhësia e familjeve (mesatarja)	6.5	6.9	7.2	7.5	7.8	7.6	5.7	5.0



Gratë në Zhabar janë aktive në sektorin e bujqësisë, bletarisë, frizere, rrobaqepëse duke përfshirë edhe përpunimin dhe kultivimin e perimeve, e ku shumë prej tyre u janë ofruar mundësi trajnimi dhe mbështetje nga organizata si “CECD-friends” së bashku me “QAK MITROVICËN E JUGUT” ku ju kanë ndihmuar personave të riatdhesuar me grante.

Shkollimi. Në këtë fshat vazhdon të mbetet prioritet shkollimi duke siguruar që brezat e rinj të kenë mundësi për arsimim dhe arritje akademike që do të kontribuojnë akoma më shumë në avancimin e pozitës së shoqërisë së këtij fshati por edhe në zhvillimin social e ekonomik. Ka një shkollë fillore që ofron mësim nga klasa 1-9. Në shkollën e Zhabarit aktualisht janë duke ndjekur mësimin 430 nxënës, mësimi mbahet në dy ndërrime për të menaxhuar numrin e nxënësve dhe kushtet në shkollë.

Kopshti. Shumica e grave kanë fëmijë të moshës 0-6 vjeç, por një pjesë e mirë nuk i dërgojnë në kopsht, kryesisht për shkak të mungesës së kopshtit në fshat, largësisë së tij në qytet, mungesës së transportit të rregullt, kostove të larta financiare dhe angazhimeve familjare. Ka raste ku gratë e shohin të domosdoshme të kujdesen vetë për fëmijët, për shkak të pamundësisë për t'i dërguar në kopsht.

“Po, shkojnë në kopsht, mirëpo kemi shumë probleme për shkak të transportit dhe rrugës shumë të largët për në kopsht.”

“Fëmija im nuk shkon në kopsht sepse momentalisht është vetëm një (1) kopsht publik dhe është larg fshatit Zhabar, numri i fëmijëve që pranohen është i kufizuar dhe në mungesë të transportit të rregullt e kam të pamundur.”

Ekziston **një institucion parashkollor** pranë një shkolle në zonën më të afërt, por është larg për pjesën më të madhe të banorëve dhe mungon transporti publik, ndaj shfrytëzohet vetëm nga familjet që banojnë afër tij. Si rezultat, një pjesë e grave nuk kanë mundësi t'i dërgojnë fëmijët në kujdes parashkollor, duke i detyruar të qëndrojnë në shtëpi.

Sipas përgjigjeve të mbledhura nga gratë e fshatit Zhabar i epërm, kopshti më i afërt ndodhet mesatarisht në distancë prej 5-6 kilometra nga fshati. Rruga deri te

kopshti shpesh është në gjendje të keqe, sidomos gjatë dimrit, gjë që e bën shumë të vështirë qasjen. Për familjet që nuk kanë makinë private, largësia dhe mungesa e transportit publik të rregullt paraqesin

një pengesë serioze për dërgimin e fëmijëve në kopsht, duke ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë e grave për të qenë aktive në tregun e punës ose në angazhime të tjera jashtë shtëpisë.

Rreth 1/3 e të intervistuarëve dërgojnë fëmijët në kopsht në qytet. Disa theksojnë vështirësi të kostos sepse duhet dërguar me vetura dhe nganjëherë të lihet puna më herët për të marrë fëmijët në kopsht. **Rreth 2/3 nuk dërgojnë fëmijët në kopsht.** Disa nga gratë theksojnë se nuk mund të kërkojnë punë sepse duhet përkujdesur për fëmijët dhe vjehrrit si dhe fakti që ajo nuk punon është arsye për mosdërgim në kopsht. Disa theksojnë koston e shtrenjtë të kopshtit, distancën dhe mungesën e transportit të rregullt.

Transporti publik ka vetëm dy linja me kombi për Mitrovicë, nga ora 06:30 dhe 18:30, me biletë 0.50€ (vajtje-ardhje) dhe zgjat afër 20 minuta. Transporti është pengesë sepse disa zona të fshatit janë larg pikave të ndalimit. Mungesa e transportit të rregullt publik është një nga sfidat kryesore për banorët e Zhabarit, sidomos për gratë. Edhe pse në fshat janë dy linja me kombi, kjo nuk i mbulon të gjitha zonat e fshatit. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e tyre për të punuar jashtë shtëpisë, pasi mungesa e transportit ua pamundëson lëvizjen e rregullt. Për disa është problem që kombi që ofron transport për qytet është larg lagjes së tyre në fshat, disa nuk kanë patent shofer dhe një thekson se nuk ndjehen rehat nëse fëmijët janë aq larg. Një prind thotë se është vështirë të plotësojnë kushtet për kopsht publik.

“Kemi filluar të mendojmë për të lëvizur në qytet sepse fëmijët janë rritur dhe shkollimi në qytet është më i mirë”

Shpërngulja. Nga 21 gra të intervistuar, shumica shprehin dëshirën për të shpërngulur në qytet, kryesisht për shkak të mungesës së mundësive për punë dhe arsimit më të mirë për fëmijët. Arsyet kryesore janë: (a) mungesa e kushteve për familjet me fëmijë të vegjël (kopsht, shkolla, transport), (b) shpenzimet dhe vështirësitë e transportit për në qytet, (c) kufizimet në mundësitë ekonomike dhe shërbimet në fshat, (d) nuk ka mjaft mundësi për punë dhe shkollë cilësore në fshat, (e) kushtet më të mira për fëmijë të vegjël, (f) në përgjithësi mundësi më të mëdha

në qytet si për punësim, etj. 8 nga ta nuk kanë dëshirë të shpërngulen në qytet dhe 3 nuk mendojnë tani për tani, dhe varen nga kushtet që do të ofrohen në të ardhmen.

Disa shërbime do të ngadalësonin shpërnguljen janë (a) transporti adekuat, (b) mësimi gjithë-ditor, (c) kopshti, (d) qëndrime ditor dhe kujdesi ndaj të moshuarëve, (e) qender për aktivitete kulturore dhe sportive për fëmijët dhe të rinjtë, që të mos largohen drejt qytetit. Përveç mungesës së transportit dhe qasjes së vështirë në parashkollor, një tjetër faktor që kufizon mundësinë e grave për të hyrë në tregun e punës është mungesa e qendrave për përkujdesjen e të moshuarëve. Shumë gra janë të obliguara të kujdesen për vjehrrit ose prindërit e moshuar, dhe për shkak të mungesës së alternativave, nuk kanë mundësi të angazhohen në punë të rregullta jashtë shtëpisë. Kjo barrë e padukshme e kujdesit familjar po i mban shumë gra të izoluar ekonomikisht dhe pa mundësi zhvillimi personal dhe profesional.

Punësimi. Në shumicën e familjeve punon vetëm burri, ndërsa gruaja shpesh kujdeset për fëmijët dhe shtëpinë. Nga të gjithë të anketuarit, në 14 familje punon vetëm burri, në 4 familje punojnë si burri ashtu edhe gruaja, në 2 raste nuk punon asnjëri. Në një rast, gruaja e la punën për t'u kujdesur për fëmijët dhe të moshuarit. Shumica e grave që nuk punojnë përmendin mungesën e kujdesit për fëmijët si arsye kryesore, si dhe mungesën e mundësive të punës.

“Burri punon si ndërtimtar, unë jam në shtëpi dhe kujdesem për fëmijën dhe për prindërit e moshuar të burrit, gjithashtu merrem edhe me punimin e tokës ndonjëherë kur të kam kohë”

Nga respondentët është kuptuar që 3 burra punojnë në fshat, 8 jashtë fshatit, 3 punojnë në fshat dhe qytet apo varësisht sipas punës. Disa shkojnë në punë me biçikletë gjatë verës, dhe kombi/taksi gjatë dimrit dhe disa përdorin një automjet së bashku. Disa përdorin automjetet personale apo me taksi privat por nuk ka orar. Në tri raste kompania u ka dhënë kombi,

“Diku rreth 5 km, por rruga është e keqe dhe dimrit është edhe më e vështirë për ta përshkuar”

“Në qytet ka më shumë mundësi. Fëmijët do të kishin pasur kopsht, unë do të mund të gjeja punë edhe nuk do të kishin pasur aq shumë shpenzime për rrugë”

sidomos nëse janë disa punëtorë nga fshati, siç janë disa që punojnë në ndërtimtari. Një pjesë kufizohen të punojnë në fshat. Për fshatrat e mëdha dhe të shpërndara, nganjëherë disa lagje shërbehen e tjera jo.

Shkaqet që gratë deklarojnë se janë të papuna janë të ndryshme. Rreth 25% e tyre thonë se nuk ka punë të disponueshme, ndërsa 30% pohojnë se nuk kanë shkathtësi të duhura ose se mungesa e transportit për në një lokacion tjetër i pengon të punojnë. Po ashtu, 30% e konsiderojnë transportin tepër të kushtueshëm, duke e bërë punën të paleverdishme. Për 35% të grave, kostoja e kujdesit për fëmijët është aq e lartë, sa që e bën të paleverdishme kërkimin e një pune. Megjithatë, arsyeja kryesore që del nga të dhënat është pamundësia për të siguruar kujdes për fëmijët, e cila është përmendur nga 60% e të anketuarave si pengesa më e madhe për të qenë të punësuar.

Pothuajse të gjitha gratë janë shprehur se prania e transportit publik efektiv, me orar të rregullt dhe me kosto të arsyeshme, do t'ua rriste mundësinë për t'u punësuar. Shumë prej tyre theksojnë se kjo do t'i ndihmonte të lëviznin lirshëm në qytet për të kërkuar punë apo trajnime dhe do t'i motivonte më shumë. Disa e lidhin transportin edhe me mundësinë për të dërguar fëmijët në kopsht, duke e parë si kusht të rëndësishëm. Ka raste kur mungesa e transportit ka qenë arsyeja kryesore që kanë ndërprerë punën, ndërsa të tjera besojnë se një shërbim i tillë do të ndihmonte shumicën e grave të fshatit Zhabar.


“Një kohë kam punuar edhe unë edhe burri, tash vetëm burri, unë jam ndalë për shkak të fëmijëve, duhet me u kujdes për kopsht me i dërgu me i marrë, për bukë etj”



Komuna e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka **64,742 banorë**, përfshirë **qytetin dhe 44 fshatra** dhe gjithsej **16,584 ekonomi familjare**.


Komuna e Mitrovicës mbase është **një nga komunitat që ka fituar dhe humbur më së shumti popullatë** si pasojë e industrializimit të hovshëm dhe deindustrializimit pastaj.




Fshati Zhabar

Popullsia në fshatin Zhabar të Epërm është **rreth 936 banorë**, me **187 ekonomi familjare**. Ndodhet në jug të Ibrit me popullsi shumicë shqiptare.

Popullsia në fshatin Zhabar (1948 - 2024)



Familjet në Zhabar



Një numër i madh i fëmijëve nuk shkojnë në kopsht për shkak të **mungesës së kopshtit në fshat, largësisë së kopshteve në qytet, mungesës së transportit të rregullt, kostove të larta financiare dhe angazhimeve familjare**.

Gratë në Zhabar janë aktive në sektorin e **bujqësisë, bletarisë, frizere, rrobaqepëse**, si dhe **përpunimin dhe kultivimin e perimeve**.

Shumicës së grave u janë dhënë **ofruar mundësi trajnimi dhe mbështetje përmes granteve** nga organizata të ndryshme joqeveritare.

"Fëmija im nuk shkon në kopsht sepse momentalisht është vetëm një (1) kopsht publik dhe është larg fshatit Zhabar, numri i fëmijëve që pranohen është i kufizuar dhe në mungesë të transportit të rregullt e kam të pamundur."

"Kemi filluar të mendojmë për të lëvizur në qytet sepse fëmijët janë rritur dhe shkollimi në qytet është më i mirë"

"Një kohë kam punuar edhe unë edhe burri, tash vetëm burri, unë jam ndalë për shkak të fëmijëve, duhet me u kujdes për kopsht me i dërgu me i marrë, për bukë etj"

